



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENSIA E SHËRBIMEVE TË SPORTIT
DREJTORI

Nr. 22/1 prot.

Tiranë, më 31.07.2023

MIRATOHET

DREJTOR

Bledar Doçi



KODI ETIKES

AGJENSISE SHËRBIMEVE TE SPORTIT

Në mbështje të Ligjit nr.152\2013 Për nëpunësin civil, i ndryshuar Ligjit nr.9367 datë 07.04.2005 Për parandalimin e konfliktit në interes të ushtrimit të funksioneve publike i ndryshuar, ligjit nr.9131 datë 08.09.2003 Për rregullat e etikës në administratën publike të hartohet ky kod etike I Agjensisë së Shërbimeve të Sportit.

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Fillimi

Kodi I etikës ka për qëllim të përcaktojë normat dhe rregullat e sjelles të punonjësve të Agjensisë së Shërbimeve të Sportit gjatë ushtrimit të autoritetit publik në përputhje me standartet ligjore e nënligjore të kërkuara me qëllim garantimin e integritetit profesional e moral paanshmërinë dhe pavarsinë në ushtrimin e detyrës\ funksionit.

Neni 2

Fusha e veprimit

Dispozitat e këtij Kodi janë të detyrueshme të zbatohen nga të gjithë punonjësit që kanë marrdhënie punësimi me Agjensinë e Shërbimeve të Sportit që rregullohet me aktet Ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Fusha e veprimit

1. Cdo punonjës i Agjensisë së Shërbimeve të Sportit e ushtron detyrën e tij në përputhje me

- a. Parimin e Ligjshmërisë
- b. Parimin e profesionalizmit
- c. Parimin e objektivitetit pavarësinë, paanësinë, dhe mosdiskriminimin
- d. Parimin e përgjegjshmërisë dhe refuzimit të urdhërave të paligjshëm
- e. Parimin e transparencës dhe konfidencialitetit
- f. Parimin e shmangjes së konfliktit të interesit

Neni 4

Parimi I ligjshmërisë

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë të cdo punonjësi të Agjensisë duhet të rrespektojë Kushtetutën legjislaconin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë dhe të mbrojtë të drejtat e liritë e njeriut si dhe të shërbejë interesit publik.

Neni 5

Parimet e profesionalizmit

1. Cdo punonjës i ASHS-së duhet të kryej me profesionalizëm dhe në përputhje me ligjin detyrat e tij si dhe të azhurnohet me ndryshimet ligjore dhe nënligjore të legjislaconit , në Republikën e Shqipërisë për këtë qëllim.
2. Cdo punonjës i ASHS-së duhet të përmisojë në vazhdimësi aftësitë e tij profesionale nëpërmjet rritjes individuale profesionale formimit profesional dhe trajtimeve të vazhdueshme.
3. Bazuar në parimin e profesionalizmit cdo punonjës duhet të zotrojtë njohuri dhe aftësi në nivelin që kërkohet për përmbushjen e detyrës që ushtron duke garantuar cilësi dhe standart të lartë profesional të punës në raport jo vetëm me eprorët por dhe me kolegët.

Neni 6

Parimi i objektivitetit pavarësisë

1. Cdo punonjës i ASHS-së duhet të kryej detyrën e tij zyrtare me ndershmëri , objektivitet paanshmëri dhe pa diskriminim a paragjykim ndaj përkatësive etnike fetare, kombësie, përkatësisë.

- shoqërore, gjinore dhe cdo gjëndje tjetër e cila përbën shkak për diskriminimin dhe trajtim të njëanshëm.
2. Në ushtrimin e detyrave cdo punonjës i ASHS-së merr masa të mbrojtje pavarësinë e tij nga ndikime të brëndshme e të jashtme të cilat mund të ndikojë në kryerjen e detyrave të tijë apo në vendimmarrje.

Neni 7

Parimi i përgjegjshmërisë dhe rrefuzimit të urdhërave të paligjshëm

1. Gjatë ushtrimit të detyrës së tij punonjësi i ASHS-së duhet të jetë i kujdesshëm dhe i përgjegjshëm për dhënien e mendimeve në mënyrë publike.
2. Cdo punonjës i ASHS-së mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e cdo veprimi apo mosveprimi të tij gjatë ushtrimit të detyrës.
3. Cdo punonjës i ASHS-së duhet të veprojë në përputhje me urdhërat dhe udhëzimet të shkruara apo verbale të marra nga eprorët hirearkik sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të Agjencisë duke dëshmuar integritet të lartë moral, në funksion të arritjes së misionit dhe ruajtjes së imazhit të institucionit.
4. Cdo punonjës i ASHS-së nëse ka dyshime për paligjshmërinë e eprorit nuk e zbaton urdhërin por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhërin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.
5. Cdo punonjës ka detyrim ta zbatojë urdhërin me shkrim me përjashtim të rastit kur përbën vepër penale.

Neni 8

Parimi i transparencës dhe konfidencialitetit

1. Cdo punonjës i ASHS-së duhet të jetë transparent në ushtrimin e detyrës.
2. Cdo punonjës i ASHS-së duhet ta përdorë informacionin që disponon apo që vihet në dijeni gjatë ushtrimit të detyrës vetëm për qëllim të realizimit të saj dhe nuk mund ta përdorë informacionin në tejkalim të qëllimit për të cilën është në dijeni.
3. Në asnjë rast apo rrethanë punonjësi nuk mund t'ju japë informacionin në lidhje me detyrën që ushtron personave të tretë brënda apo jashtë institucionit përveç rasteve kur autorizohet nga eprori direkt.
4. Përhapja e informacionit nga punonjësi i ASHS-së është vënë në dijeni për shkak të detyrës në mënyrë të paautorizuar brënda apo jashtë institucionit përbën shkelje disiplinore.
5. Punonjësi i ASHS-së, i cili për shkak të informacionit vihet në dijeni me të dhënat personale detyrohet të ruaj konfidencialitetin e këtyre të dhënave gjatë ushtrimit të detyrës së tij, sipas përcaktimeve ligjore në ligjin nr.9887 datë 10.03.2008 Për mbrojtjen e të dhënave personale, i ndryshuar.

6. Cdo punonjës i ASHS-së gjatë ushtrimit të detyrës duhet të tregojë kujdes në ruajtjen dhe publikimin e informacionit në përputhje me ligjin nr.119\2014 Për të drejtën e informimit.

Neni 9

Parimi i shmangies së konfliktit të interesit

1. Cdo punonjës i ASHS-së duhet të marrë masa konkrete për parandalimin shmangien dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave në përputhje me ligjin nr.9367 datë 07.04.2005, Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike I ndryshuar, si dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij.
2. Në asnjë rast punonjësi nuk duhet ta realizojë detyrën e tij, me paramendim për të realizuar përfitim material, moral apo profesional për vete apo familjen e tij.
3. Gjatë ushtrimit të detyrës së tij punonjësi I ASHS-së nuk duhet të pranojë apo të kërkojë ,në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë të mira materiale, dhurata, trajtime preferenciale, premtime për veten apo familjarët e tij për shkak të detyrës që ai kryen.
4. Në rastin e dhuratave protokollare, ato duhet të raportohen menjëherë.
5. Cdo punonjës I ASHS-së në rast se konstaton që gjendet në kushtet e konfliktit të interesit duhet të njoftojë menjëherë eprorin direkt si dhe të marrë masa për shmangjen e konfliktit të interesit, në përputhje me legjislacionin përkatës së fushës.

Neni 10

Ushtrimi i veprimtarisë së jashtme

1. Ushtimi i veprimtarive të jashtme do të kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të kësaj fushe. Në cdo rast kryerja e veprimtarive të jashtëme nuk duhet të sjellë vonesa apo pengesa për kryerjen e detyrave që mbartin punonjësit e ASHS-së.
2. Veprimtaria e jashtme e punonjësve të ASHS nuk duhet të çënojë interesat e reputacionin e institucionit të ASHS-së dhe as të çënojë pavarësinë dinjitetin dhe integritetin moral e profesional të tij.

KREU II

MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE DHE NDËRINSTITUCIONALE

Neni 11

Mardhëniet mes kolegëve dhe mardhëniet epror+ vartës

1. Punonjësit e ASHS-së gjatë komunikimit me punonjës të tjerë , duhet ti përmbahet me korrektësi strukturës organizative sipas shkallës së hierarkisë të përcaktuar në të.
2. Komunikimi midis eprorëve dhe vartësve dhe anasjelltas si dhe komunikimi midis kolegeve në cdo kohë l përshtatet rregullave të etikës në administratën publike të këtij kodi.
3. Në funksion të kryerjes së detyrave, marrdhëniet midis eprorëve dhe vartësve si dhe marrdhëniet midis kolegëve duhet të ndërtohen mbi baza të mirëkuptimit respektit reciprok dhe solidaritetit.
4. do të konsiderohen shkelje të etikës profesionale rastet e mosinformimit të kolegut për gabimet e mundshme që ky mund të kryej gjatë procesit të punës shprehja në prani e të tretëve mbi të metat e kolegut vartësit, eprorit apo punës së tyre , mosshkëmbimi i mendimeve dhe informacioneve të përgjithshme për mbarevajtjen punës që personat kanë dijeni gjatë punës së tyre, si dhe tonet e larta apo fjalët fyese në raport me kolegët, vartësit apo eprorët.

Neni 12

Marrdhëniet me të tretët

1. Marrdhëniet e komunikimit me të tretët përfshin persona fizikë apo juridike publikë apo privatë kryhen nga nëpunësi vetëm me dijeninë dhe pelqmin e eprorit direkt dhe duke respektuar rregullat e etikës.
2. Në cdo rast punonjësit e ASHS-së duhet që të sigurohet që kontrolli i të dhënave verifikimi i tyre, mbledhja e informacionit këqyrja e dokumenteve justifikuse dhe korespondenca me subjektet e tjerë të jetë në përputhje me qëllimin për të cilin kërkohet apo mblidhet ky informacion dhe jo në tejkallim të tij.
3. Marrdhëniet dhe komunikimi me institucionet realizohen nga nëpunësi i autorizuar verbalisht apo me shkrim nga titullari i institucionit duke respektuar kodin e etikës.
4. Punonjësi i ASHS-së duhet të sillet me integritet dhe korrektësi edhe në ambientet publike , duke shmangur cdo sjellje që mund të interpretohet ose lidhet në ndonjë mënyrë me pozicionin e tij institucional.

KREU III
RREGULLA TË VECANTA

Neni 13

Respektimi i orarit dhe kujdesit në punë

1. Punomjësi i ASHS-së duhet të jetë i përkushtuar në kryerjen e detyrës shfrytëzimin e kohës së punës vetëm për qëllim realizimin e detyrave të tij.
2. Brenda orarit zyrtar Punonjësi i ASHS-se nuk duhet të largohet nga vendi i punës pa marrë miratim nga eprori i tij, apo në mungesë të tij nga Drejtori i ASHS.
3. Mjetet dhe pajisjet e punës duhet të përdoren me kujdes dhe vetëm për nevojat e punës.
4. Në ambientet e punës nuk lejohet komunikimi me zë të lartë, përdorimi i mjeteve elektronike në zë të lartë, apo cdo lloj zhurme e cila shkakton pengesë në realizimin e detyrave.

Neni 14

Pijet alkoolike dhe pirja e duhanit

Për një prezantim dinjitozë punonjësi i ASHS, në ambientet e institucionit janë të ndaluara konsumimi i pijeve alkoolike, duhanit, apo cdo produkti, i cili pengon kryerjen e detyrës me përgjegjshmëri.

Neni 1

Veshja gjatë orarit zyrtar

1. Veshja gjatë orarit zyrtar duhet të jetë e përshtatshme dhe e tillë që të shprehë kujdesin dhe seriozitetin e vazhdueshëm, nivelin e domosdoshëm të pastërtisë personale si dhe vëmendje në mënyrën e qëndrimit në ambientet e institucionit.
2. Cdo lloj veshje që nuk i përshtatet përshkrimit të pikës 1 të këtij neni do konsiderohet shkelje e etikës në punë.

KREU IV
STRUKTURA PËRGJEGJËSE E ETIKËS

Neni 16

Autoriteti përgjegjës për mbyqyrjen e etikës

1. Juristi i ASHS-së është autoriteti përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e Kodit të Etikës
2. Juristi i ASHS-së në rastet kur evidentohet shkelje të këtij kodi nga ana e punonjësve të ASHS-së vë në dijeni Drejtorin e ASHS-së, i cili kur e gjykon të arsyshme kërkon nisjen për marjen e masave disiplinore ndaj punonjësit që ka kryer shkelje në përputhje me dispozitat ligjore.
3. Juristi i ASHS-së si autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij Kodi, mbikqyr dhe i raporton Drejtorit, sa herë i kërkohet prej tij.
4. Cdo punonjës i ASHS-së është i detyruar të raportojë pranë autoritetit përgjegjës.

Neni 17

Dispozitat e fundit

1. Përsa nuk parashikohet në këtë Kod punonjësi i ASHS duhet të konsultohet me eprorin e tij drejtpërdrejt dhe në rast pamundësie me titullarin e institucionit.

Neni 18

Dispozitat zbatuese

1. Cdo punonjës i ASHS-së merr masa për zbatimin e këtij Kodi.
2. Shkelja e këtij Kodi me faj përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor.